



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KUVENDI

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

### PROCESVERBAL

Tiranë, më 28.05.2018, ora 11:00

**Drejton mbledhjen:**

**Ulsi Manja – kryetar i Komisionit**

#### **Rendi i ditës:**

1. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për shtesën e financimit për projektin e burimeve ujore dhe ujitjes dhe të marrëveshjes për ndryshimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për financimin e projektit të burimeve ujore dhe ujitjes”. *(Komision për dhënie mendimi)*

2. Projektvendimi “Për ngritjen e Komisionit të Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e Zbatimit të ligjit nr 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë””. *(Komision përgjegjës)*

#### **Marrin pjesë:**

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Bledar Çuçi, Spartak Braho, Edmond Leka, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Elena Xhina, Ermonela Felaj (Valikaj), Arben Pëllumbi dhe Tom Doshi.

#### **Mungojnë:**

Enkelejd Alibeaj, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi Tyli, Fatmir Mediu, Nasip Naço, Silva Caka.

#### **Të ftuar:**

Ilir Halilaj – Zëvendësministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Irfan Tarelli – Drejtor i Përgjithshëm

Etleva Alushi – Specialiste e Projektit të Burimeve Ujore

Tedi Bushaj – përfaqësues i Drejtorisë së Borxhit Publik

Elona Mistrovica – specialiste në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Brikena Jazhi – specialiste në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

## HAPET MBLEDHJA

**Ulsi Manja** – Mirëmëngjesi! Përshëndetje! Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme. Kuorumi formohet, kështu që vazhdojmë me rendin e ditës.

Kalojmë në shqyrtimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për shtesën e financimit për projektin e burimeve ujore dhe ujitjes dhe të marrëveshjes për ndryshimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për financimin e projektit të burimeve ujore dhe ujitjes”.

Komisioni ynë është komision për dhënie mendimi. Relator i këtij projektligji është kolegu Edmond Leka. Nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural kanë konfirmuar pjesëmarrjen: zoti Ilir Halilaj, zëvendësministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, zoti Irfan Tarelli, drejtor i Përgjithshëm, dhe zonja Etleva Alushi, specialiste e Projektit të Burimeve Ujore.

Nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë kanë konfirmuar pjesëmarrjen: zoti Tedi Bushaj, përfaqësues i Drejtorisë së Borxhit Publik, zonja Elona Mistrovica, specialiste dhe Brikena Jazxhi, specialiste.

U lutem përfaqësuesve të ministrive, të cilët kanë ardhur për marrëveshjen, të zënë vendet!

Ju lutem, bëni një prezantim të shkurtër të kësaj projekt marrëveshjeje për kolegët deputetë, edhe pse ata janë njohur më marrëveshjen, për opinionin publik dhe për mediet.

Zoti Halilaj, fjala është për ju.

**Ilir Halilaj** – Përshëndetje të gjithëve, të nderuar deputetë!

Na falni për vonesën!

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për shtesën e financimit për projektin e burimeve ujore dhe ujitjes dhe të marrëveshjes për ndryshimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për financimin e projektit të burimeve ujore dhe ujitjes” ka dy komponentë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Na falni, se ishim te Komisioni i Ekonomisë!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Nuk ka problem. E plotësove përgjigjen.

Mund të vazhdoni, zoti Zëvendësministër!

**Iir Halilaj** – Në thelb, kjo marrëveshje është një shtesë, e cila i bëhet marrëveshjes ekzistuese prej 31 milionë eurosh me Bankën Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim. Ajo synon të rehabilitojë rreth 7 skema ujitëse që dalin nga rreth 11 ndërhyrje, të cilat janë bërë në digat dhe rezervuarët me marrëveshjen ekzistuese. Gjithashtu, kemi edhe një zgjatim të marrëveshjes ekzistuese me Bankën, ku kërkohet shtyrja e projektit prej 4 milionë eurosh, të cilat janë kursyer nga marrëveshja ekzistuese 31 milionë euro.

Nga marrëveshja ekzistuese janë disbursuar rreth 24 milionë euro deri tani dhe janë nënshkruar rreth 41 kontrata, nga të cilat 32 kanë përfunduar dhe pjesa tjetër është në proces implementimi.

Marrëveshja ekzistuese përfshin rehabilitimin e 11 digave dhe 5 skemave të ujitjes dhe të kullimit me një sipërfaqe prej 20 mijë hektarësh. Marrëveshja shtesë prej 23 milionësh do të vërë nën ujë rreth 16 mijë e 500 hektarë.

7 skemat ujitëse, të cilat financohen me marrëveshjen e re, janë: Murriz-Thanë në Bashkinë e Lushnjës; Tregtan 2 dhe 3 në Bashkinë e Hasit; Sllanicë në Bashkinë e Kuçovës; Leminot në Bashkinë e Maliqit dhe sistemi i ujitjes me rezervuarët Janjar-Mursi, me skemat Mursi-Xarrë-Konispol dhe Vagalat në Bashkinë e Konispolit.

Financimi përfshin edhe administrimin e kontratave të punimeve civile nëpërmjet shërbimeve të mbikëqyrjes, si dhe furnizimin e instalimin e instrumenteve të sigurisë për 14 diga të rezervuarëve ujitës në zonën e projektit, duke përfshirë trajnimin e stafit për përdorimin e tyre.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Zëvendësministër!

Fjalën e ka zoti Leka.

**Edmond Leka** – Faleminderit, zoti kryetar!

Qëllimi i këtij projektligji është ratifikimi i marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim.

Objektivat kryesorë të projektit janë: krijimi i kuadrit strategjik për menaxhimin e burimeve ujore në nivel kombëtar dhe në basenet e lumenjve Drin-Bunë e Seman dhe përmirësimi i ofrimit të shërbimeve të ujitjes në sistemet e përzgjedhura të ujitjes.

Projekti ndahet në komponentët e mëposhtëm: rehabilitimi i digave dhe i sistemeve të ujitjes dhe kullimit; mbështetja institucionale për ujitjen dhe kullimin; mbështetja institucionale për menaxhimin e integruar të burimeve ujore dhe mbështetja për zbatimin e projektit.

Në aspektin ligjor dhe procedural projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe me Rregulloren e Kuvendit.

Në fakt, meqë jam relator, dua të ngre disa çështje për diskutim, por kam edhe disa pyetje.

E para, duke qenë se miratimi i projekt marrëveshjes për shtesën e financimit dhe ndryshimet në marrëveshjen ekzistuese të huas janë bërë me dy vendime të veçanta të Këshillit të Ministrave, si e argumentoni në relacionin shoqërues dhe si është vlerësuar që procedura e ratifikimit të tyre të bëhet nëpërmjet një propozimi të vetëm dhe nuk është përcjellë në dy-tri projektligje të ndryshme?

Si është ndarë ky projekt sipas zërave, domethënë sa për qind shkon për rehabilitimin e digave dhe sa për qind shkon për kullim dhe ujitje?

Cilat zona janë parashikuar kryesisht? Pse nuk është parashikuar rehabilitimi i digave në lumin Vjosë, duke marrë parasysh që lumi i Vjosës, përveç Drinit dhe Bunës, është lumi që sjell përmbytjet më të mëdha në zonën jugore të vendit. Meqenëse këtë vit dhe vitin e kaluar jemi përballur me përmbytje të mëdha në zonën jugore të vendit dhe duke qenë se unë i kam ndjekur të gjitha punimet që janë bërë në digat për mbrojtjen nga përmbytjet, a jeni në dijeni dhe a keni marrë në dorëzim punimet që janë kryer në këto diga, sepse kemi vënë re se pjesa më e madhe e punimeve që janë kryer në diga nuk janë cilësore dhe në investimet që janë bërë kemi vënë re se të gjitha digat kanë përfunduar, jo si mos më keq, por nuk ekzistojnë fare si diga. Këto të dhëna i kam nga përmbytjet e fundit në lumin Vjosë.

Faleminderit kryetar!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Leka!

Zoti Halilaj, fjala për ju.

**Illir Halilaj** – Faleminderit për pyetjet!

Në lidhje me përfshirjen në të njëjtin akt, edhe të shtyrjes së huas, edhe të marrëveshjes së re, për shkak se afati ekzistues është më 31 maj të vitit 2018, u konsiderua që do të kursente kohë dhe këto dy akte do të përfshiheshin në një. Pra, do të ishte efiçente nga kjo pikëpamje.

Për sa i takon një lloj detajimi të ndërhyrjeve, kemi shtatë skema ujitëse që do të trajtohen me këtë marrëveshje, me 23 milionëshin. Kemi dy skema në Has “Tregtan 2” dhe “Tregtan 3”,

kemi një skemë në Kuçovë “Sllanica” në Maliq “Leminoti”, kemi degën Lushnjë të kanalit Murriz-Thana dhe degën Çukas, po në Lushnjë. Ndërkohë, kemi edhe skemën ujitëse me rezervuarin e Janjarit në Konispol.

Për çështjen që përmendet, kjo marrëveshje synon të trajtojë skemat ujitëse, që kanë të bëjnë me marrëveshjen ekzistuese me Bankën Botërore. Pra, me vlerën 31 milionë janë bërë ndërhyrje në 11 diga dhe rezervuare, ndërkohë 23 milionëshi parashikon që në shtatë prej tyre të kryejë zgjatimin e skemave ujitëse, që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me këto rezervuare. Këto skema nuk kanë të bëjnë me mbrojtjen nga përmbytjet, sepse në vetvete janë skema ujitëse dhe ndërhyrja në Vjosë, siç e përmendët edhe ju, nuk është parashikuar brenda kësaj marrëveshjeje.

Lidhur me cilësinë e punimeve të kryera deri tani me marrëveshjen ekzistuese, janë ngritur dy grupe pune, që po punojnë në terren për të evidentuar cilësinë dhe për të vlerësuar konformitetin me kontratat në secilën prej këtyre ndërhyrjeve, ku do të dalim në një përfundim.

**Edmond Leka** –Për digat në të cilat është investuar më parë, a jeni në dijeni se në çfarë situatë ndodhen sot?

**Ilir Halilaj** – Ka një ndarje mes pushtetit vendor dhe Ministrisë së Bujqësisë për menaxhimin e rezervuarëve dhe digave që kanë lidhje me to. Ne kemi rreth 7 të tilla në administrim, ndërkohë pjesën tjetër e ka pushteti vendor.

**Ulsi Manja** –A ka pyetje të tjera nga kolegët?

Po, zoti Fino.

**Bashkim Fino** – Që të jem i qartë: ne kemi kaluar shumën totale prej 31 milionësh, sot ju vini këtu për shtesën 23 milionë. Nga 31 milionë, 24 milionë janë dhënë dhe, ju thatë se nga 41 kontrata, 32 kanë përfunduar. Nga 31 milionë, 24 milionë, që kanë përfunduar, 7 milionë janë në proces, kur mbarojnë nga kontrata e parë? Sot ju vini me një kontratë të re për 23 milionë, të cilën ne e miratojmë dhe do të quhet kredi, me të dhëna dhe terma financiarë, për 25 vjet, duke përfshirë edhe periudhën 7 vjet, pa paguar principalin, pra 23-milionëshi, 0,25% shuma e kredisë dhe 0,25% llogaritët mbi vlerën e padisbursueshmërisë së huas. Pyetja që kam unë, përveç 31-milionëshit, sepse 24 janë realizuar, ku deputeti tha se ka vërejtje edhe për realizimin e tyre, kanë mbetur 7 milionë pa realizuar, ku janë këto 7, që nuk janë realizuar? 23 milionëshin që do të kalojmë sot, ju në relacion në faqen katër e keni ndarë në dy kategori, kategoria 1, ku thoni: “Punime, mallra, shërbime konsulence, trajnime, shkronja “b”, pjesë të tjera të shumës që përbëjnë 22 milionë e 942 mijë e 500 euro”. Pra, kjo është llokma më e madhe e këtij 23-milionëshit. Të gjitha këto që i

përmenda, i theksova me presje. Kategoria e dytë është tarifa “Front end”, që është në shumën 57 mijë e 500 euro. Nëse i mbledh të dyja këto, shkojnë 23 milionë. Më e lezetshme është që qeveria shqiptare dhe ministrja juaj do ta paguajnë TVSH-në dhe mbi të gjitha do të ketë një kosto lokale, në shumën 4,6 milionë euro, që do të thotë se taksën lokale do ta paguajë Bashkia Lushnjë.

Së pari, dua të di, ju si ministri, a e keni planifikuar koston lokale të këtyre bashkive? A janë të gatshëm ta paguajnë, sepse nuk janë pak, por 4,6 milionë euro?

Së dyti, ju nuk keni bërë detajimin e rreth 23 milionë eurove. Unë si deputet, që të jem i qetë që të votoj, dua ta di unë se si janë ndarë konsulenca, trajnimet dhe pjesa kryesore, punët civile, mallrat e të tjera. Pse nuk e bëni të detajuar këtë 23 milionëshin, që unë të di sa janë trajnimet, sa janë konsulencat dhe sa është pjesa kryesore e investimit, sepse aty mund të ketë fonde pa pasur nevojë që bashkitë të paguajnë kosto lokale. Bashkitë nuk i kemi aq të pasura sa të paguajnë 4,6 milionë euro taksë lokale, nuk kanë ku ta gjejnë koston lokale kaq të lartë. Ky është thelbi. Ne pyesim për efektshmërinë, sepse ne, në fund të fundit, kemi të drejtë thjesht të miratojmë kredinë dhe në momentin që miratojmë kredinë ne si parlament kemi mbaruar punë dhe fillon puna juaj. Puna juaj, me marrëveshjen që është firmosur për të marrë kredi, duhet të jetë e detajuar, sepse janë lekët e shqiptarëve. Ju mos përfitonit nga ngritja e dorës që bën pozita dhe opozita, sepse ne të gjitha i miratojmë, por ju duhet të vini këtu me një relacion të detajuar deri në qindarkën e fundit se ku shkojnë këto fonde, sepse i paguajnë fëmijët e mi, të tuajt, madje edhe fëmijët e fëmijëve për 25 vjet. Domethënë, me këtë borxh që do të marrim, a do të bëhen si duhen 7 digat e ujëmbledhësve? Ky është thelbi, sepse kjo marrëveshje kalon për dy sekonda, ne të gjithë dakord jemi, bëhet marrëveshja mes Ministrisë së Financave dhe Bankës Botërore, por problemi është se si do të ekzekutohen këto që merren, si do të hidhen dhe si do të trajtohen? Ju këtu nuk më qartësoni që unë të votoj jo për shumën që ka kërkuar Ministria e Financave dhe Banka Botërore, por për mënyrën se si do ta financoni ju dhe si do të shpërndahen këto fonde.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Fino!

**Ilir Halilaj** - 4,6 milionë euro, që janë kosto lokale, kanë të bëjnë me TVSH-në. Këto janë parashikuar në projektbuxhetin e ministrisë për vitet në vazhdim 2019-2020.

**Bashkim Fino** – Sa është kostoja lokale...

*(Ndërhyrje pa mikrofoni)*

**Ulsi Manja** – Të lutem, zoti Fino!

Urdhëroni!

**Bashkim Fino** – Ju kërkoj ndjesë!

Zoti kryetar, problemi është shumë i thjeshtë. Në qoftë se do të japim përgjigje të tilla, pra që janë në koston, janë në buxhetin e ministrisë për këtë vit dhe për vitin tjetër, ju lutem, mos më fyeni, unë nuk dua të më fyeni për inteligjencën që kam për buxhetin, sepse e njoh mirë. Dua të di: sa është kjo kosto lokale për vitin 2018? Është 2,1. Pjesa tjetër, 3,1 është në 2019. Këtë do ta verifikojmë në tetor, kur të vijë projektbuxheti i vitit 2019 nëse do të jetë 3,1 kjo kosto, sepse duhet të jetë e shkruar atje.

Unë prandaj ndërhyra, dhe ju kërkoj ndjesë juve dhe zëvendësministrit, ose ktheni përgjigje tamam, ose thoni se nuk jeni në gjendje të ktheni përgjigje dhe do të ktheni përgjigje më vonë. Ju kërkoj ndjesë dhe një herë!

**Ulsi Manja** – Mund të vazhdoni zoti Halilaj.

**Ilir Halilaj** – Në fakt, është i drejtë shqetësimi, pasi jemi në shqyrtim të buxhetit për vitin 2019, që do të detajojë edhe mbështetjen me kosto lokale të këtij projekti nga ana e ministrisë. Dua të theksoj se këto kosto janë të parashikuara në buxhetin e ministrisë, nuk kanë të bëjnë me buxhetet e bashkive, pra për efekt të ekzekutimit të këtij projekti. Nuk do të kemi ndonjë pengesë për efekt mosparashikimi nga ana e bashkive të pjesës së tyre të kostove. Ndërkohë, negocimi i financimit të marrëveshjes është bërë në bazë të dokumentit të projektit, i cili është negociuar me Bankën Botërore, ku është detajuar se cilat kosto shkojnë për punimet civile dhe cilat shkojnë për konsulencë, për projekttime dhe kështu me radhë.

**Ulsi Manja** – Zoti Hyseni e ka kërkuar fjalën për pyetje.

**Alket Hyseni** – Faleminderit, zoti kryetar!

Zoti zëvendësministër, duke u konsultuar po vë re se kjo kredi do të përdoret edhe në zonën time pjesërisht, prandaj jam shumë i interesuar, sepse ne para një viti u kemi premtuar atyre njerëzve se brenda këtij mandati do të përmbyllim çështjen e kanaleve kulluese dhe vaditëse. Pra, ky projekt është shumë i mirëpritur dhe e vlerësoj ministrinë.

Unë dua të kem një informacion më konkret, në vijim të asaj që tha zoti Fino, çfarë vlere ka projekti sistemi i ujitjes me rezervuar Janjar-Mursi me skemat Mursi-Xar-Konispol dhe Vagalat? Për sa kohë e keni parashikuar këtu, besoj se ministria e di se një nga këto shtatë zërat është kaq. Unë që të votoj, pavarësisht se jemi komision për dhënie mendimi dhe nuk jemi komision përgjegjës, dua një informacion më konkret dhe t'u them njerëzve kur të shkoj në zonë se kaluam këtë gjë me këtë efekt.



Së dyti, në vijim të shqetësimit të kolegut Leka, besoj se është vendi për t'i tërhequr vëmendjen ministrisë sot, pavarësisht se dje, brenda së njëjtës qeveri, nuk kemi administruar ne atë ministri, por konkretisht flas nga terreni. Investimet e bëra në skemën e kanalizimeve dhe digave kanë qenë inefficente, flas për qarkun Vlorës, konkretisht për zonën e Delvinës. Bëhen investime në kanale parësore, pa u bërë në rrjetin dytësor, gjë që nuk jep asnjë efekt dhe shkatërron edhe këtë investim, por edhe atje ku bëhen këto investime kanë krijuar probleme shumë të mëdha. Prandaj, në këtë kuadër, kërkoj që ministria të bëjë një audit, ku të dimë se çfarë çorbe është bërë në 4 vjetët e kaluara dhe shumë më tepër se në 4 vjet, e menaxhuar nga një dorë, e cila, në opinionin publik, njihet shumë mirë se çfarë menaxhimi u ka bërë fondeve publike, me cilëndo qeveri që ka qenë në aleancë, qoftë me PD-në, qoftë edhe me PS-në. Po paguajmë lekë nga buxheti, po marrim kredi, ajo që tha zoti Fino, që do të paguhet nga ne dhe fëmijët tanë, dhe nuk po japim produkt në terren. Është më mirë që të mos i bëjmë nëse nuk kanë eficiencë.

Së dyti, zoti zëvendësministër, në lidhje me bordin e kullimit ne gjykojnë se është inegzistent, që jemi te skema e digave, e kanaleve kulluese dhe vaditëse. Kemi pasur përmytje dhe nuk e kemi pasur mbështetjen e këtij institucioni, prandaj, ju lutem, na thoni: çfarë është parashikuar në këtë fokus?

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Hyseni!

Urdhëroni, zoti Halilaj!

**Ilir Halilaj** – Në lidhje me skemën ujitëse me rezervuarin e Janjarit në Konispol, kostoja totale e projektit është rreth 6,9 milionë euro dhe do të mbulojë me ujë rreth 4 mijë hektarë në atë zonë.

Në lidhje me investimet inefficente, sidomos në qarkun e Vlorës dhe në zonën e Delvinës, kemi një ndarje të kanaleve ujitëse dhe kullues me bashkitë, pra parësorët i ka ministria, ndërkohë sekondarët dhe terciarët i kanë bashkitë. Sot po diskutonim me Ministrinë e Financave pak a shumë të njëjtën gjë, pra mekanizmin financiar që kanë bashkitë në dorë për t'i trajtuar këto problematika nga ana e tyre. Është e drejtë ajo që përmendet që, në qoftë se kryhet një investim në një kanal kryesor dhe kanalet dytësore nuk funksionojnë, atëherë tokat nuk vaditen, pra është e thjeshtë. Ndërkohë, kemi disa qasje pozitive nga Bashkia e Fierit, që është shumë agresive në këtë drejtim, pra i trajton përgjegjësitë e saj mbi kanalet me shumë agresivitet dhe përgjegjësi. Ndërkohë, duhet bërë shumë edhe nga bashkitë e tjera, të cilat duhet të vënë në dispozicion pajisjet

që kanë, sepse të gjitha bashkitë kanë mjete në dispozicion, për të kryer investime, me forcat e tyre, në kanalet sekondare dhe terciare që kërkojnë vëmendje.

Në lidhje me çështjen e auditit të menaxhimit të kontratave dhe të investimeve publike të bëra në 4 vjetët e shkuara, por edhe më herët, këtë do ta mbajmë shënim si çështje për t'ia referuar ministrit për një angazhim konkret.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Halilaj!

Urdhëroni, zonja Felaj!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë po shoh relacionin dhe tekstin zyrtar të marrëveshjes së nënshkruar me Bankën për Rindërtim dhe Zhvillim dhe si fillim ju tërheq vëmendje për relacionin, sepse fshati Slanicë nuk ka qenë dhe nuk është pjesë e bashkisë Kuçovë, por pjesë e bashkisë Ura Vajgurore.

Në pikën 18 të marrëveshjes thuhet: “Sistemet e përzgjedhura të ujitjes janë digat e mëposhtme dhe sistemet e tyre, duke filluar me fshatrat: Toplanë, Vranisht, Tregtan, Muristan, Kurjan, Strum, Zharrëz, Sllanicë, Belesovë, Duhanas, Starareska, Leninot dhe Koshnicë”.

Pika 18 e marrëveshjes nënkupton që të gjitha këto sisteme janë pjesë e kësaj marrëveshje që duhet të miratojmë? Në relacion thuhet që janë shtatë sisteme ujitëse ku do të realizohen këto ndërhyrje, ndërkohë që, sipas pikës 18, janë më shumë.

Po ndjek logjikën që si fillim janë përzgjedhur shtatë dhe pastaj do të vazhdohet me të tjerat. Mbi çfarë baze është bërë kjo përzgjedhje? Belesova dhe Duhanasi, të dy fshatra të qarkut Berat, përkatësisht në bashkinë e Kuçovës dhe atë të Beratit, janë shumë më të mëdhenj dhe përfshijnë më shumë sipërfaqe toke sesa Sllanica, që është një fshat shumë më i vogël në tokë bujqësore si sasi, por edhe në numrin e banorëve që ka. Mund të kem një përgjigje për këtë gjë?

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zonja Felaj!

Mund të përgjigjet edhe specialisti që keni marrë me vete, zoti zëvendësministër. Rëndësi ka t'u jepet përgjigje pyetjeve të koleges.

**Illir Halilaj** – Zonat që përmendët në pikën 18 të marrëveshjes nuk janë pjesë e shtatë skemave, por kanë të bëjnë me marrëveshjen ekzistuese. Pra, marrëveshja ekzistuese mbulon me ujitje rreth 22 500 hektarë, kurse marrëveshja e re rreth 16 500 hektarë. Pra, është ndërhyrë në to me anë të marrëveshjes ekzistuese.

Për sa u përket kritereve që janë ndjekur për të bërë këto zgjedhje, në fakt, këto janë zona që lidhen direkt me ndërhyrjen nën marrëveshjen ekzistuese, pra, nën 31 milionë euroshin

e investimit që është bërë deri tani. Në qoftë se është ndërhyrë në diga dhe rezervuarë tek ajo marrëveshje, atëherë bëhet investimi në kanale që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me këto rezervuarë.

**Ulsi Manja** – Faleminderit!

Po, zona Felaj.

**Ermonela Felaj** – Ndoshta këtu nuk është vendi për të debatuar për këtë gjë, por unë ju kërkoj të verifikoni ku kanë shkuar fondet për Belesovën. Ju zoti zëvendësministër ishit i pranishëm në llogaridhënien që u bë në Kuçovë dhe kjo pyetje u ngrit edhe atje. Ky rezervuar është komplet jashtë funksionimit. Sot e kësaj dite, të gjithë banorët e njësisë administrative Lumas e kanë problem vaditjen në zonën e tyre. Ju ftoj ta verifikoni këtë gjë. Është detyrim ligjor të ndërmerri veprimet përkatëse për mënyrën se si janë përdorur dhe ku kanë shkuar ato fonde, sepse njerëzit nuk kanë përfituar asgjë nga to.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zonja Felaj!

Ka pyetje të tjera nga kolegët? Nuk ka. Diskutime?

Po, zoti Fino.

**Bashkim Fino** – Faleminderit për fjalën!

Duke parë që nuk mora përgjigje për pyetjet që bëra, jam i detyruar të bëj disa komente dhe sqarime dhe mbi bazën e saj të vendos për të votuar projektvendimin.

Ne, sot, duam të miratojmë kredinë prej 23 milionë euro. Pra, ne sot duam të miratojmë kredi për 23 milionë, jo 31 milionë. 31 milionëshi ka kaluar me kohë.

Në relacion, kur unë kërkoja detajimin e 23 milionëshit, zëvendësministri tha se është marrëveshje e bërë me Bankën Botërore dhe e kanë të detajuar. E rilexova edhe një herë, pasi mendova mos kishin bërë ndonjë gabim dhe nuk e kishin parë, dhe në materialin bashkëngjitur shikoj që ne kemi vetëm një tërheqje të fondeve të huas për 31 milionë euro. 31 milionë euro janë të detajuara. Për mendimin tim, edhe këtu ka shumë paqartësi, sepse thotë që pjesa e tretë e projektit, përveç mallrave, për pjesën 3C, janë 48 mijë e 400 euro. Pjesa tjetër e projektit, pjesa e luanit, është 30 milionë e 136 e 527, por projekti quhet i përgjithshëm. Mallra për pjesën 3C të projektit janë 240 mijë. Më pas vazhdon më poshtë: shpenzime operative shteruese: 90 mijë euro dhe rimbursimi i paradhënies për përgatitjen e projektit: 407 e 500 mijë, rreth 408 mijë euro. Çfarë do të thotë? Kur bëhen të gjitha këto pagesa për projekte, do të thotë se projektet bëhen të rregullta, sepse, të marrësh rreth 500 mijë euro për të bërë projektin e një kanali kullues apo të një rezervuari,

e të tjera, do të thotë se në funksion të projektit duhet të zbatosh pjesën e investimit. Kur janë shifra kaq të mëdha të projekteve, detyrimisht që edhe investimet do të bëhen shumë serioze. Unë nuk e pashë të detajuar në këtë material shumë prej 23 milionë eurosh, që do të shërbejë për financimin e kategorive ë mëposhtme, që i përmenda edhe kur bëra pyetje, qoftë në kategorinë e parë, punime civile, mallra, shërbime, konsulencë, trajnime, e të tjera, qoftë edhe në kategorinë e dytë, por kjo është 57 mijë e 500, apo edhe në koston lokale, që u tha se janë të parashikuara në buxhetin e Ministrisë së Bujqësisë për vitin në vazhdim dhe vitin që vjen. Në momentin që ne nuk i kemi të detajuara, Ministria e Financave, por edhe ministria që e përfiton këtë investim bashkë me bashkitë, duhet të kuptojnë se duhet ta sjellin të detajuar relacionin dhe materialin. Ne nuk mund të futemi dot në teknalitete kur bëhet marrëveshja midis Ministrisë së Financave dhe Bankës Botërore.

Ka të pranishëm këtu nga Ministria e Financave?

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Ju jeni?

Dakord. Më shumë e kam fjalën për ju.

Unë mund të hyj në teknalitete, sepse pjesa juaj si financë është sa do të jetë principali, sa do të jetë përqindja e interesit, për sa vjet e marrim, kemi apo nuk kemi interes apo e gjejmë në vend tjetër këtë shumë parash.

Është e njëjta gjë si të marrë një qytetar një kredi në bankë, nëse i pëlqejnë normat e interesit, i merr, nëse nuk i pëlqen, nuk e merr. Pjesa tjetër, pasi merret kjo shumë, ka të bëjë me ministritë e linjës, me bashkitë përkatëse për të bërë investimin përkatës dhe për të pasur efektivitetin e nevojshëm në bashkitë e ndryshme. Të marrësh një kredi për 25 vjet, që ta paguajnë fëmijët tanë dhe të mos jetë investim serioz, sepse ti si Ministri Finance vetëm këtë bën, sepse janë rreth 408 mijë euro, kot që ne i marrim këto lekë, pasi duhet të rishikohen me kujdes.

Mua më duket absurde për sa kohë që ne nuk e kemi të detajuara dhe unë nuk mora përgjigje të detajuar për 23 milionëshin, për të cilin edhe ju, të nderuar kolegë, do të ngrini dorën për ta miratuar atë që ka miratuar Ministria e Financave, e cila ka hedhur firmë për ta marrë këtë kredi. Si mund ta votoj, kur nuk e di se ku do të shkojnë këta 23 milionë? Do të shkojnë për trajnime, për konsultime apo për projekte të tjera? Fakti që nuk është e detajuar do të thotë se ministria e linjës, në rastin konkret, duhet të bëjë një punë të hollësishme, një relacion të

hollësishëm dhe të na i sjellë këtu deri sa ta kalojmë ne propozimin që kam unë, deri në seancë plenare, zoti kryetar.

Komisioni i Ekonomisë, që është më i përgjegjshmi dhe më efektiv në raport me ne, mbase i kanë kërkuar këto të dhënat dhe mbase i kanë marrë, por gjithsesi, nëse i kanë në Komisionin e Ekonomisë, të na i sjellin edhe në një kopje mbi bazën e pyetjeve dhe diskutimeve që bëmë, me qëllim që të qartësohemi deri në seancën plenare për të votuar projektligjin.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Fino!

A ka diskutime të tjera nga kolegët?

Përfaqësuesi nga ministria ka një sqarim.

**Tedi Bushaj** – Shqetësimi që ngre zoti Fino është plotësisht i drejtë, megjithatë unë dëshiroj t’ju sjell në vëmendje që negociatat që janë bërë më BB-në janë përkthyer në një dokument projekti. Pra të gjithë zërat që janë përfshirë në mënyrë përmbledhëse në marrëveshje janë të detajuara. Ne mund t’ju vëmë në dispozicion dokumentin e projektit, që përmban të gjitha si: vlerën për çdo objekt, shërbimet e mbikëqyrjes, komponentin e trajnimeve, etj. Pra, është i detajuar në mënyrë definitive. Këtu janë paraqitur të Këshillit të Ministrave dhe janë negociuar bashkarish nga Ministria e Financave dhe Ministria e Bujqësisë.

**Ulsi Manja** – Unë jam shumë dakord dhe bashkohem edhe me shqetësimet e kolegëve të mi këtu. Në fakt, ne jemi komision për dhënie mendimi dhe të gjitha këto shqetësime do të duhet t’ia përcjellim Komisionit të Ekonomisë, si komision më teknik për sa u përket detajeve të projektit, por përpara se ta hedhim në votim, unë dua të them dy fjalë nisur edhe nga shqetësimet e kolegëve. Është shumë e vërtetë që nëpërmjet kësaj marrëveshjeje do të futen në skemën e vaditjes rreth 16 mijë e 500 hektarë në këto 7 zona zhvillimi, më duket se thatë.

Në fakt, ne kemi mbështetur vazhdimisht projekte të tilla në këtë komision, por edhe në Kuvend, sepse janë skema që u vijnë në ndihmë fermerëve dhe banorëve të këtyre zonave, që e kanë lidhur jetën me fshatin. Po ashtu është shumë evident fakti që është përgjegjësi e Ministrisë së Bujqësisë të ndjekë zbatimin e këtyre projekteve, por edhe t’u japë përgjigje shqetësimeve të deputetëve dhe banorëve të këtyre zonave se ku kanë shkuar këto investime. Kjo është një kampion alarmi për Ministrinë e Bujqësisë dhe ju thatë se do t’i mbani shënim çështjet e ngritura nga kolegët e mi këtu, që nuk kanë lidhje me marrëveshjen dhe se do t’ia transmetonit ministrit, por, të nderuar përfaqësues të Ministrisë së Bujqësisë, korrupsioni nuk luftohet me duar në xhepa. Ju

duhet të bëni transparent se ku kanë shkuar investimet, dhe jo vetëm ju, por çdo ministri, qoftë nga buxheti i shtetit, qoftë nga donatorë të tjerë lidhur me mbështetjen dhe subvencionimin që jepet për bujqësinë dhe fshatin. Kolegia thotë që është financuar një rezervuar aty, por nuk ka ujë, ose nuk është bërë fare. E di që kur të filloni auditimin ata do të thonë se është tharë rezervuari nga temperatura, por, problemi është se atje janë derdhur lekët tona, pra lekët e taksapaguesve shqiptarë.

Herën tjetër, kur të vini në këtë komision për të kërkuar votën tonë për marrëveshje të tilla, do t'ju kërkojmë llogari për zbatimin e këtyre projekteve, që ne mbështesim me votë. Është detyrë dhe përgjegjësi e parlamentit të kërkojë zbatimin e këtyre marrëveshjeve dhe projektligjeve që votojmë.

Kështu që, duke u bashkuar me shqetësimet e kolegëve të mi, do të duhet ta hedhim në votim në parim këtë projekt marrëveshje, me të gjitha shqetësimet që u ngritën këtu. Relatori do t'i bëjë pjesë të relacionit, të cilin do t'ia përcjellë komisionit përkatës. Nuk kemi arsye të bëhemi pengesë për këtë skemë financimi, ku futen rreth 16 mijë e 500 hektarë në skemë vaditjeje, por, shqetësimet duhet t'i adresojmë.

Kush është dakord në parim më projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për shtesën e financimit për projektin e burimeve ujore dhe ujitjes, dhe të marrëveshjes për ndryshimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit të burimeve ujore dhe ujitjes”?

11 pro. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin nen për nen.

Kush është dakord me nenin 1?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 2?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord në tërësi me projekt marrëveshjen?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Së bashku me raportin përkatës, ftoj kolegun Leka t'ia përcjellim Komisionit të Ekonomisë, si komision përgjegjës.

Falënderoj përfaqësuesit e ministrisë për prezencën në komision!

Ju uroj ditë të mbarë!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KUVENDI

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

### PROCESVERBAL

Tiranë, më 28.05.2018, ora 11:00

**Drejton mbledhjen:**

**Ulsi Manja - kryetar i Komisionit**

#### **Rendi i ditës:**

Projektvendim “Për ngritjen e Komisionit të Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e zbatimit të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë””

#### **Marrin pjesë:**

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Bledar Çuçi, Spartak Braho, Edmond Leka, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Elena Xhina, Ermonela Felaj (Valikaj), Arben Pëllumbi dhe Tom Doshi.

#### **Mungojnë:**

Enkelejd Alibeaj, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi Tyli, Fatmir Mediu, Nasip Naço, Silva Caka.

#### **Të ftuar:**

Ilir Halilaj – Zëvendësministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Irfan Tarelli – Drejtor i Përgjithshëm

Etleva Alushi – Specialiste e Projektit të Burimeve Ujore

Tedi Bushaj – përfaqësues i Drejtorisë së Borxhit Publik

Elona Mistrovica – specialiste në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë



Brikena Jazxhi – specialiste në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

**Ulsi Manja** – Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës, por më parë kërkoj ndjesë, sepse duhej ta kisha bërë që në fillim. Më lejoni t'i uroj mirëseardhjen në Komisionin e Ligjeve zotit Spartak Braho, i cili ka qenë vazhdimisht anëtar i këtij komisioni! Punë të mbarë, zoti Braho!

Pika e dytë e rendit të ditës është projektvendimi “Për ngritjen e Komisionit të Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e Zbatimit të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

Komisioni ynë është komision përgjegjës DHE relator është Adnor Shameti. Më lejoni të sqaroj kolegët! Ky është një projektvendim i propozuar nga unë dhe nga kolegja Klotilda Bushka, pra, është një nismë ligjvënëse e dy deputetëve të këtij komisioni edhe pse mund të kishin qenë më shumë, në fakt. Ky projektvendim është një detyrim që buron nga ligji “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, konkretisht neni 288 i këtij ligji, që bën fjalë për ngritjen e Komisionit të Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e Zbatimit të Ligjit nr. 115/2016. Projektvendimi është formuluar dhe për detaje të tjera unë e ftoj kolegen Bushka që të bëjë një prezantim të shkurtër të këtij projektvendimi për kolegët dhe për opinionin publik!

Zonja Bushka, fjala është për ju.

Ju lutem shkurtimisht, pastaj do të kalojmë në pyetje dhe diskutime.

**Klotilda Bushka** – Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë, në fakt siç e tha edhe kryetari, ky projektvendim është në funksion të zbatimit të reformës në drejtësi. Kuvendi ka një nga prioritetet e punës së tij edhe përmbushjen e funksioneve kushtetuese dhe ligjvënëse sa i takon zbatimit të reformës në drejtësi, duke pasur parasysh detyrimin e nenit 288, të ligjit për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë, nr. 115/2016. Është detyrë e Kuvendit të vijojë procedurën për ngritjen e një komisioni të pavarur, i cili përbëhet nga juristë me një eksperiencë prej 15 vjetësh në profesionin e gjyqtarit, të avokatit, të noterit apo juristë nga fusha të ndryshme dhe ky komision do të ketë si detyrë të koordinojë punën midis institucioneve dhe organeve që zbatojnë parashikimet ligjore të ligjit për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë, si dhe të ndjekë ecurinë e zbatimit të parashikimeve ligjore nga institucionet respektive të parashikuara në ligj, brenda afateve ligjore të përcaktuara po në ligj. E gjithë ideja është që ne si nismëtarë, por edhe Kuvendi në të gjithë anëtarësinë e tij, ka detyrimin që në bazë të ligjit për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë ta ngrejë këtë komision të

pavarur, për monitorimin dhe koordinimin e punës së ngritjes së organeve të reja të sistemit të drejtësisë.

Nga reforma e drejtësisë, kemi tashmë një rikonfigurim të të gjitha organeve të reja të sistemit të drejtësisë ose do të kemi ritransformim të atyre që janë ekzistuese. Të gjitha këto organe të parashikuara në ligj do të ngrihen apo do të ristrukturohen, sipas procedurave të posaçme që vetë ligji i parashikon dhe po vetë ligji parashikon edhe detyra për organe të ndryshme, qoftë Kuvendi, organet e pushtetit ekzekutiv apo vetë organet ekzistuese të pushtetit gjyqësor, që duhet të plotësojnë disa detyrime në ngritjen e këtyre institucioneve.

Gjithashtu, në këtë proces futet edhe procesi tashmë shumë i mirëpritur nga publiku, procesi i vetingut, i cili është një parakusht për ngritjen e organeve të reja të drejtësisë sa i takon kompozimit të tyre me anëtarë, të cilët e kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit.

Në gjithë këtë proces, që në krye të herës reforma ka pasur parashikuar një organ të pavarur, të përbërë nga profesionistë, të cilët do të shihnin se si afatet ligjore, se si detyrat e organeve të ndryshme të shtetit zbatohen në kohë dhe ashtu siç e parashikon ligji, në mënyrë që në radhë të parë Kuvendi të informohet nga ky komision i pavarur për gjithë procesin dhe ecurinë e kësaj pune.

E dyta, të bëhet e mundur që detyrimet ligjore dhe afatet të plotësohen.

E treta dhe më e rëndësishmja, publiku të jetë i informuar në kohë, në mënyrë institucionale për ecurinë e ngritjes së organeve të reja të drejtësisë.

Në fakt, duke qenë se ne jemi të vonuar në ngritjen e këtij komisioni, ku edhe herë të tjera në këtë komision kemi diskutuar faktin që ka pasur një mungesë të Kuvendit në realizimin e detyrës së tij për ta ngritur dhe shpeshherë nga ne janë dhënë edhe arsye, dua t'ju rikujtoj ju dhe publikut faktin që ligji për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë detyrën për ngritjen e këtij komisioni ia ka caktuar Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Deri me fillimin e kësaj legjislature, pavarësisht se detyrimi ligjor ka qenë në legjislaturën e kaluar, nuk është ndërmarrë ndonjë nismë për ngritjen e këtij komisioni, edhe pse ka qenë detyrim ligjor.

Me fillimin e legjislaturës së re ky komision mori në shqyrtim të gjitha detyrat që kishte për sa i takon procesin të zbatimit të reformës në drejtësi. Gjithashtu, kemi pasur zgjedhjen e anëtarëve nga radhët e jo prokurorëve dhe jo gjyqtarëve për Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë, si edhe procese të tjera, të cilat i keni njohur dhe janë bërë edhe publike nga ky komision, siç ka qenë edhe zgjedhja e Prokurorit të Përgjithshëm me detyrë të përkohshme, por edhe detyra të tjera, të cilat i kemi realizuar gjatë kësaj kohe. Nisma që vjen sot

është pikërisht për të mos humbur më kohë në plotësimin e një detyrimi ligjor që ka Kuvendi, prandaj ne e morëm si nismë.

Siç e tha edhe kryetari Manja, këtë nismë mund ta kishte marrë kushdo, ndoshta edhe më shumë deputetë, thjesht për të mos humbur më kohë në plotësimin e detyrave ligjore që ka Kuvendi, duke qenë se Komisioni i Ligjeve do të jetë komision përgjegjës, që nesër, pasi të ngrihet komisioni i pavarur, do të duhet ta informojë komisionin. Pra, ne e morëm këtë nismë, e cila parashikon në mënyrë të detajuar se si do të ngrihet ky komision, cilat janë kriteret e përzgjedhjes, procedurat. Gjithsesi, kjo është një nismë që duhet shqyrtuar dhe miratuar në komisionin tonë, por do të jetë seanca plenare e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, e cila do të duhet ta miratojë gjithë këtë proces në mënyrë që ne ta kemi atë komision që parashikon neni 288 i ligjit për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë, i cili do të monitorojë dhe koordinojë punën e të gjitha organeve të këtij shteti që kanë detyra të përcaktuara qartë dhe afate kohore për t'i zbatuar në lidhje me ngritjen e organeve të reja të sistemit të drejtësisë.

**Ju faleminderit!**

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zonja Bushka!

Ligji për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë ka qenë i atakuar në Gjykatën Kushtetuese dhe vendimi i Gjykatës Kushtetuese në raport me këtë ligj daton në fundin e vitit 2017. Në fakt, jo për t'u shmangur nga përgjegjësitë, ne do të duhej të kishim avancuar me ngritjen e këtij komisioni, gjithsesi me zbatimin e nenit 288 të ligjit për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë, Kuvendi i Shqipërisë përmbush edhe një nga detyrimet e fundit që ka në kuadrin e zbatimit të reformës në drejtësi, për sa i përket ngritjes dhe kompozimit të organeve të reja të sistemit drejtësisë.

Gjithsesi, për detajet e këtij projektvendimi ne jemi të hapur me kolegët, por para se të kalojmë në pyetje dhe diskutime, fjalën do t'ia jap relatorit, zotit Shameti.

**Adnor Shameti** – Faleminderit, zoti kryetar!

Pasi ju dhe kolegja Bushka analizuat në mënyrë të detajuar nevojën e ngritjes së këtij komisioni si një detyrim kushtetues që buron nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, i paraqesim Komisionit të Ligjeve projektvendimin “Për ngritjen e komisionit të pavarur për koordinimin, monitorimin dhe ndjekjen e zbatimit të ligjit”, nr. 115, të vitit 2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”. Ashtu sikurse ju, edhe kolegja Bushka iu referuat nenit 288 të ligjit të sipërpërmendur, nga i cili buron nevoja e ngritjes së këtij komisioni dhe në këto kushte i është

propozuar komisionit ky projektvendim, i cili parashikon ngritjen e komisionit të monitorimit të organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë, si dhe çështjet që lidhen me përbërjen dhe kriteret e nevojshme të përzgjedhjes së anëtarëve, procedurën për zgjedhjen e tyre, si dhe rregullat për organizimin, funksionimin dhe vendimmarrjen e këtij komisioni. Nisur nga rëndësia që ka ngritja e një komisioni të pavarur për të ndihmuar Kuvendin dhe të gjithë aktorët e përfshirë në procesin për zbatimin e detyrimeve kushtetuese dhe ligjore të reformës në drejtësi, dhe posaçërisht për zbatimin e ligjit nr.115 të vitit 2016, ftoj të gjithë anëtarët e këtij komisioni që ta votojmë këtë projektvendim!

**Ulsi Manja**- Faleminderit!

A ka pyetje nga kolegët?

Po, zoti Braho.

**Spartak Braho** – Unë e vlerësoj pozitivisht iniciativën për ngritjen e këtij komisioni. Ka vend për ndonjë kritikë për zvarritjen. Ajo që dua të më qartësojnë formuluesit është se çfarë kompetencash vendimmarrëse ka ky komision kur konstaton shkelje? Në projekt nuk i gjejmë. Të ngremë komisione monitorimi është një fjalë shumë e madhe, por konkretisht çfarë mendohet për kompetencat e këtij komisioni?

**Ulsi Manja**- Faleminderit!

Në fakt, veprimtaria e këtij komisioni është e përcaktuar qartësisht në nenin 288, ky komision raporton pranë Komisionit të përhershëm përgjegjës për Çështjet Ligjore të Kuvendit dhe përpara Kuvendit të Shqipërisë për ecurinë e zbatimit të ligjit sa herë është e nevojshme. Pra, ky komision sjell në vëmendjen e Kuvendit të gjithë ecurinë dhe dinamikën e zbatimit të reformës në sistemin e drejtësisë, pastaj është përgjegjësi e Kuvendit, brenda sferës së përgjegjësisë që ka Kuvendi, për të kërkuar nga këto organe zbatimin me përgjegjësi të ligjit dhe përshpejtimin e afateve kohore të përcaktuara në ligj lidhur me ngritjen e organeve të reja të sistemit të drejtësisë. Pra, është një organ, le të themi, koordinues dhe i këtyre agjencive të reja që krijohen për shkak të reformës në drejtësi, por edhe si një organ informues i Kuvendit të Shqipërisë. Deri këtu e ka sferën e veprimtarisë dhe të përgjegjësisë ky komision. Pra, është komision i pavarur, që bën koordinimin në midis institucioneve dhe organeve që zbatojnë parashikimet ligjore të këtij ligji, si edhe ndjek ecurinë e zbatimit nga institucionet respektive brenda afateve ligjore të përcaktuara. Këtë mision i ka dhënë ligji për të rritur ndjeshmërinë e zbatimit të ligjeve të reja të reformës nga institucionet respektive.

Këtë mision e realizon duke vënë në dijeni dhe duke informuar herë pas here Komisionin e Ligjeve, si edhe Kuvendin.

**Spartak Braho-** Unë nuk jam dakord të ngremë komisione pa kompetenca. Unë e di ligjin, ashtu është, informon, koordinon, por desha të di a shkarkon njeri ky komision?

**Ulsi Manja-** Po, zoti Fino.

**Bashkim Fino-** Në vazhdim të kësaj që tha zoti Braho, edhe unë aty e kam thelbin e pyetjes sime, sepse, po të lexojmë projektvendimin, jam dakord me parafolësit, ne e bëjmë, sepse ligji i organeve të sistemit të drejtësisë, neni 288, me sa di unë, na e kërkon një gjë të tillë për ta bërë. Por në pikën 6 të këtij projektvendimi ju thoni se vendimet e komisionit quhen të miratuara me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve. Po çfarë vendimesh do të marrim ne, kur neni 288 thotë që këta do të bëjnë koordinimin, monitorimin e një pune që do të bëjë sistemi i drejtësisë, për të cilën do të vijë këtu të raportojë në komisionin tonë, madje i është dhënë mundësia të raportojë edhe në Kuvend të Shqipërisë për ecurinë, për të mirat të këqijat. Çfarë është ky komision që ta kuptojë edhe publiku?

Në qoftë se Partia Demokratike e ka kërkuar këtë para dy vjetësh me forcë si një komision me ekspertë të pavarur, nuk ka bërë gjë tjetër veçse ka zëvendësuar Drejtorinë e Monitorimit që ka këtu në parlament. Është kuvendi politik, i zgjedhur nga votat e popullit nga të gjitha partitë politike, që bën monitorimin, shikon zbatimin e ligjit, kontrollon qeverisjen, pushtetin lokal, pushtetin vendor, ligjet që bëjnë. Ne bëjmë ligje për t'i miratuar. Pak minuta më parë miratuam një kredi. Ne kemi të drejtë ta kontrollojmë atë pasi e kemi miratuar. Pra, këtë gjë kemi të drejtë ta bëjmë edhe me reformën në drejtësi, siç e kemi bërë, të zbatojmë reformën e drejtësisë që është miratuar, sepse është pluralizëm parlamenti shqiptar, ka çdo parti politike anëtarë, të cilët janë të detyruar, pavarësisht se mungojnë kolegët e mi, pavarësisht se mungon opozita sot, të koordinojnë. Pra, ky është një komision, i dashur publik, të cilin e ka kërkuar Partia Demokratike me 5 veta, 5 juristë, që hajdeni t'i zgjedhim ata, të cilët do të na bëjnë nga një memo, do të kenë edhe ndonjë zyrë këtu, do të jenë part-time, do të bëjnë ndonjë material, do të na e sjellin në komision, do të na bëjnë ndonjë raportim, dhe në fund atë që ngriti zoti Braho dhe unë, vendimmarrjen do ta marrim ne, nëse na takon sipas ligjit për shkarkim ose jo shkarkim. Me një fjalë zëvendësohet një drejtori monitorimi që është në Kuvend, që monitoron institucionet e pavarura, me një komision prej 5 juristësh, të cilët nuk do të merren më dhënien e materialeve, por do të merret ky komision. Kështu që, për të respektuar nenin 288, kryetar, për të mos bërë debat,

sepse po bëhet komision pas komisionesh, do të ngremë edhe një komision, do t'u japim dhe shpërblim atyre, sepse jemi të pasur ne, do t'u japim edhe nga një zyrë që të rrinë këtu dhe do të na japin ndonjë material. Pastaj, ne do ta shikojmë të arsyeshme nëse do ta marrim në konsideratë apo jo.

Pra, nga pikëpamja e zbatimit të ligjeve të organeve të drejtësisë, ky projekt është paraqitur shumë saktë. E vlerësoj më shumë relatorin se nismëtarët, sepse e ka paraqitur të saktë. Ndonjë ndryshim i vogël mund t'i bëhet, për shembull, kjo fjali që thashë unë duhet të hiqet patjetër, sepse nuk mund të marrin ata të 5-të vendim. Ata monitorojnë, por na paraqesin këtu një material, vendimin e marrim ne. Prandaj ajo fjali duhet të korrigjohet.

Nga pikëpamja e punës së përditshme, siç tha edhe Spartaku, po them edhe unë, një komision, kur ngrihet, i jepet kompetencë të emërojë, të shkarkojë, si propozojë, pra që të ketë forcën e ligjit, sepse po nuk e pati këtë forcë, kot që e ngre një komision. Ky është komision monitorimi dhe le të mos bëhemi pengesë, pse dikur PD-ja ka kërkuar se e do këtë komision me juristë të pavarur dhe hajde ta bëjmë. Ky komision ka vetëm këtë funksion, monitoron dhe na i sjell materialet neve si komision, Kuvendit të Shqipërisë dhe kaq, këtu mbaron puna e tyre dhe ata nuk kanë asnjë të drejtë tjetër.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Fino!

E thatë shumë qartë dhe shkurt, ky është një komision që do të asistojë me ekspertizë Komisionin e Ligjeve dhe Kuvendin e Shqipërisë për të pasur një...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Është një komision ekspertësh, që na asiston në punën tonë.

Fjalën e ka kërkuar zonja Hysi dhe më pas zoti Hyseni.

**Vasilika Hysi** –Faleminderit, zoti kryetar!

Ky është një detyrim ligjor që buron nga ligji për organet qeverisëse të sistemit të drejtësisë. Në qoftë se ju kujtohet, ne që kemi qenë anëtarë të komisionit *ad hoc* të reformës në drejtësi dhe që jemi marrë me analizën, ose me trajtimin e këtij projektligji, ka pasur një debat të madh lidhur me faktin se si mund të monitorohet dhe të koordinohet puna midis institucioneve kushtetuese, të pavarura të reformës në drejtësi. Në kuadër të frymës që ka pasur e gjithë reforma në drejtësi për të ulur sa të jetë e mundur ndikimin politik në punën e institucioneve, si: Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Inspektoratin e Lartë të Drejtësisë, Këshillin e

Emërimeve në Drejtësi për një sërë detyrash që këto organe do të bëjnë në zbatim të ligjit të tyre, u tha që të krijohet një komision i pavarur në modelin që ka Kuvendi i Shqipërisë me Këshillin e Integrimi Europian, i cili do të përbëhet nga personalitete të fushës, që nuk kanë lidhje me politikën, por që kanë njohje për mënyrën se si funksionon dhe është e organizuar Gjykata e Lartë, Prokuroria e Përgjithshme, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, Këshilli i Lartë i Prokurorisë është risi, dhe Inspektorati i Lartë i Drejtësisë.

Në fakt, këtë lloj pune e kemi diskutuar nëse mund ta bënte Komisioni i Ligjeve, apo shërbimet e pavarura të Kuvendit, për të sqaruar edhe në kuadër të shqetësimit që ngriti kolegu Fino. Të gjithë ekspertët që ishin të pranishëm, edhe unë kam qenë relatores e atij projektligji, arritëm në përfundimin që një ndër pesë detyrat që ka komisioni i pavarur, të cilat janë shumë të rëndësishme, është monitorimi. Pra, do të monitorojë gjithë ecurinë e procesit. Kush e bën procesin e përzgjedhjes së kandidatëve? E bëjmë ne, Komisioni i Ligjeve. Pra, Komisioni i Ligjeve bën një pjesë të procesit të zgjedhjes së anëtarëve jogjyqtarë dhe joprokurorë për Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë, anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese apo të Inspektoratit të Lartë i Drejtësisë e kështu me radhë. Pra, ishim në një farë konflikti interesi.

Së dyti, një pjesë të anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë do t'i zgjedhë vetë trupa e asamblesë së gjyqtarëve dhe prokurorëve. E diskutuam, a mund të shkojnë përfaqësues të maxhorancës apo opozitës nga Komisioni i Ligjeve të monitorojnë procesin? Ne nuk e kemi të ndaluar të jemi të pranishëm, por sa i besueshëm do të ishte një raport yni në qoftë se ky proces nuk do të bëhet ashtu siç duhet?

Së treti, flitet për koordinim midis institucioneve dhe organeve që zbatojnë ligjin për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë. A mundemi ne, me gjithë kapacitetin dhe përvojën që kemi si anëtarë, të bëjmë këtë koordinim? Kjo është një punë shumë operative. Ideja ishte që ky komision do të ketë një staf teknik, që faktikisht, ishte menduar që do të ishin dhe ata të pavarur, të mos ishin nga stafi i Kuvendit të Shqipërisë njerëz që ndjekin në dinamikë, monitorojnë procesin, bëjnë letra e rekomandime kryetarit të Gjykatës së Lartë, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Këshillit të Lartë Gjyqësor, që ata të përmbushin detyrat e tyre.

Në qoftë se do të vinte një letër nga parlamenti, mund të kishte kontestime. Ju e dini sa e politizuar është situata kur flitet për reformën në drejtësi.

Së katërti, këtu thuhet se do të ndjekë ecurinë e zbatimit, pra ka punë dinamike të përditshme. Ligji është shumë voluminoz, Shkolla e Magjistraturës është e përfshirë në të,

problematika e kualifikimeve dhe trajnimeve, është Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Inspektorati i Lartë, KLD-ja, pra ka shumë e shumë detyra.

E fundit, është raportimi. Raportohet në Komisionin e Ligjeve dhe në Kuvend sa herë që mund ta kërkojë ai, por mund ta kërkojmë edhe ne në varësi të problematikave që mund të ketë.

Në këtë kuadër, është menduar që ky komision nuk do të jetë afatgjatë, por me një kohë të caktuar deri sa të gjitha detyrimet që burojnë nga ligji për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë të fillojnë të zbatohen.

Ndjesë që u zgjata, të nderuar kolegë, por besoj është e nevojshme, sidomos për kolegët që nuk kanë qenë pjesë e reformës në drejtësi, të cilët janë deputetë të rinj dhe nuk kanë qenë pjesë e diskutimit të kësaj ideje pse duhet të ketë një komision të pavarur. Të mos harrojmë se një pjesë e kompetencave varet nga shumë institucione dhe është shumë e vështirë të koordinosh, për shembull, po marrim hartën gjyqësore, Këshillin e Lartë Gjyqësor me Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Drejtësisë.

Ndaj, dora e klasës politike duhet të jetë sa më larg për aq kohë sa kemi qenë dhe jemi të paragjykuar.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zonja Hysi!

Fjalën e ka kërkuar zoti Hyseni dhe më pas zonja Felaj.

**Alket Hyseni** – Mendoj se është e zauruar si debat arsyeja pse duhet ky komision. Jam plotësisht dakord me shqetësimet e zotit Fino dhe zotit Braho, por ky debat është tejkaluar me frymën e kësaj reforme, megjithatë, në këtë frymë dhe në këto kushte shqetësimi, e kemi të mundur të gjejmë mekanizmin aq sa na lejon ligji dhe Kushtetuta që të ripozicionojmë disa nga kompetencat.

Nuk mund ta konceptoj që të përdorim fjalën, sado që është përdorur në ligj, “koordinimi i institucioneve” kur nuk ka asnjë kompetencë me çfarë do ta koordinojë, aq më tepër kur janë edhe institucione kushtetuese të pavarura. Edhe institucioneve ekzekutive shtetërore po ua the kështu, “koordinimi”, pa ua dhënë saktë kompetencat, nuk të pyesin, jo më të pyesë këtë komision, një institucion kushtetues që nuk ka asnjë lloj varësie as nga ky, po as nga Kuvendi. Prandaj, mendoj se ka një mospërputhje mes relacionit dhe projektvendimit.

Po të lexoni relacionin, aty citohet: “Komisioni i pavarur do të evidentojë raste kur institucionet përgjegjëse nuk zbatojnë ligjin brenda afatit dhe nuk kryejnë detyrat e tyre të



përcaktuara duke ia bërë me dije komisionit të përhershëm përgjegjës, ose drejtpërdrejtë Kuvendit nëpërmjet raportimit, me qëllim që të mund t'i propozohet Kuvendit marrja e masave përkatëse". Pra, këtë që kemi në relacion ta fusim të paktën në projektvendim, se nuk bie ndesh me ligjin. Tek e fundit, ta kuptojnë edhe ato institucione, që nëse nuk zbatojnë ligjin, diçka do të ndodhë. Ka një institucion që mund ta shkundë situatën.

Së dyti, kam mendimin se ka nevojë për disa rregullime të vogla të teknikës legislative që nuk do të ndalem, por çfarë konstatoj me shqetësim, këtu përcaktohet se mund të jenë gjyqtarë e prokurorë. Nga leximi që unë i bëj, ka një hapësirë të madhe që gjyqtarë e prokurorë, të cilët kanë dhënë dorëheqjen në kuadrin e ligjit të vetingut, nuk kanë asnjë pengesë për të kandiduar në këtë proces.

Unë mendoj se duhet të bëjmë një ndalesë në këtë projektvendim. Pra, çdo gjyqtar e prokuror në të kaluarën, por edhe asnjë nga ata, të cilët, në kuadrin e ligjit të vetingut, u janë shmangur vetingut qoftë dhe me dorëheqjen, pavarësisht se shkruhet "Për shkaqe disiplinore", ne duhet at themi qartë: "As ata që nuk e kanë kaluar vetingun.". Sepse, nuk ka kuptim që një koleg jep dorëheqjen, dhe vjen të monitorojë strukturat.

Kam rezerva për konceptin e termit "jurist i nivelit të lartë", sepse lë vend për interpretime. Nuk e ka as ligji. mendoj se duhet të riformulohet, duke thënë: "jurist në nivele drejtuese të administratës" ose "jurist i administratës së lartë", sepse "jurist i lartë" nuk gjen referencë në ligj.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

TND-ja është jurist drejtues i nivelit të lartë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po ashtu, nëse gjej mirëkuptimin e kolegëve, do të doja të mos e linim çështjen e raportimit në Komisionin e Ligjeve, dhe këtu s'është nevoja të themi: komisioni përgjegjës për çështjet ligjore në Kuvend, siç thotë ligji. Këtu duhet ta themi në kohë formulimin: Komisioni për Çështjet Ligjore, sepse vetëm ai është komision përgjegjës. Raportimin ta bëjmë periodik, përveç rasteve kur komisioni e kërkon. Pra, të ketë një periudhë, që hajt ta diskutojmë nëse do të jetë tre muaj apo gjashtë muaj, por duhet të jetë periodik, të vijnë këtu e të shohim situatën. Sepse ne jemi në ngërçin që shumë institucione nuk po funksionojnë siç duhet. Disa krijohen me vonesë, disa s'janë krijuar. Pra, ne duhet të jemi më aktivë, sepse kemi edhe përgjegjësi ligjore. Do s'do opozita, unë jam i bindur se edhe ata janë me këtë frymë: që i kemi hyrë kësaj reforme dhe duhet t'i japim implementimin, edhe pse gjejnë mënyra për ta sabotuar. Por po i ezaurojnë edhe ata mënyrat e

sabotimit: s'ka më. Edhe babalizmi u ra me atë protestë-revoltë të dështuar. Atëherë hajt të jemi një çikë më aktivë në një reformë unike që kemi ndërmarrë.

Po t'i shohim pikë për pikë, mund të diskutojmë gjëra, por këto i ishin shqetësimet e përgjithshme që doja të ndaja me ju.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Hyseni!

Zonja Felaj.

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë do të doja të ndaja me ju disa sugjerime në lidhje me përmirësimin e përmbajtjes së projektvendimit, pavarësisht se, me thënë të drejtën, nuk është se bën sens që Kuvendi i Shqipërisë, në rastin e institucioneve të reja që sollin reforma në drejtësi, në njëfarë mënyre të jetë i përjashtuar nga monitorimi, nga kërkesa e llogarisë ndaj këtyre institucioneve.

Megjithatë, këtu u tha, por ka qenë e njohur edhe gjatë procesit të ndërtimit të reformës në drejtësi, se kjo ka qenë një kërkesë e opozitës. Kështu, meqenëse ka qenë kërkesë e opozitës, meqenëse ky komision i pavarur duhet të jetë sa më pak politik, mundësisht jopolitik, unë do t'ju doja ta rishikonit mekanizmin e përzgjedhjes së kandidatëve që do të jenë anëtarë të këtij komisioni, sepse kështu siç është parashikuar lë mundësinë që të jetë shumica ajo që i zgjedh me vota. Është parashikuar të zgjidhen me shumicë të thjeshtë. Për analogji mund të merrnim përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Ka një mekanizëm aty, që u lejon mundësi të dyja palëve politike që ta përzgjedhin.

Ky është sugjerimi im, nëse mund ta shikojmë, që të mos vijmë në nonsens. Në qoftë se nuk vjen, është i njëjti mekanizëm që kemi pasur edhe tek AMA, kur opozita nuk erdhi asnjë ditë të vetme, por ndërkohë ne i zgjedhëm anëtarët tanë sipas parimit një e zgjedh ti e një e zgjedh unë; mandej opozita u detyrua të vinte e t'i propozonte anëtarët e saj të AMA-s.

Tani, nëse duam të ofrojmë realisht një vendim për të qenë, unë besoj se ky është një moment që duhet riparë.

E dyta: “Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, thotë projektvendimi, ushtron funksionet deri në përfundimin e procesit të krijimit dhe fillimit të veprimtarisë së organeve, të parashikuar në ligjin nr. 115 të vitit 2016.

Faktikisht, janë dhënë dy momente, që jo domosdoshmërisht mund të përkojnë në kohë me njëri-tjetrin. Mund ta riformulojmë këtë. E dyta, të krijohet përshtypja se ky komision do të jetë

deri në momentin që mbaron zgjedhja dhe bëhet konstituimi i të gjitha organeve që parashikon ligji “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

Nëse është deri këtu, si mundet ky organ të zbatojë, fjala vjen, detyrën që ne ia kemi njohur në pikën 2, germa “c”, të ndjekë ecurinë e zbatimit të ligjit në fjalë? Se ligji ka një pafundësi kohe që do të zbatohet, nuk e di, deri në momentin ë do të ndryshohet. Besoj se edhe këtu duhet të bëjmë kujdes çfarë kemi dashur t’i japim këtij komisioni. Do të shohim deri në momentin kur organet të konstituohen? Deri këtu? Apo duam të shikojmë edhe më tej? Në momentin kur organet fillojnë nga puna, natyrisht do të kenë marrëdhënie me njëri-tjetrin. Duam që komisioni të monitorojë edhe marrëdhënien që do të zhvillohet mes organeve të ndryshme të sistemit të drejtësisë?

Në fakt, kjo është edhe një lloj pyetjeje, sepse personalisht nuk e shoh se del qartë në projekt.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zonja Felaj!

Që të jemi të qartë, njëherë: nuk është se e ka kërkuar opozita këtë, të jemi të qartë. Është kërkesë e ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”. Sigurisht që pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, opozita ka kërkuar zbatimin e nenit 288...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Më fal, të lutem! A ka mundësi ta sqaroj, se duket sikur po del që e ka kërkuar opozita, ndërsa ne tani do të duhet të gjejmë një formulë, që t’i japim akses edhe opozitës në ngritjen e këtij komisioni. Absolutisht që duhet të jemi të qartë: është kërkesë e ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, votuar me 84 vota.

Sigurisht që opozita, por jo vetëm, jo vetëm Partia Demokratike, por edhe pjesa tjetër, kanë kërkuar ngritjen e këtij komisioni të pavarur monitorimi e koordinimi, që në fazën e parë të zbatimit të ligjit “Për organet e qeverisjes”, sepse ishte në proces ngritjeje zgjedhja e anëtarëve jogjyqtarë e joprokurorë për në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e lartë të Prokurorisë. Ky komision do ta ushtrojë veprimtarinë deri në ngritjen dhe kompozimin e plotë të të gjitha organeve të reja të qeverisjes së sistemit të drejtësisë, duke filluar me Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e lartë të Prokurorisë, Inspektoriatin e Lartë të Drejtësisë, Këshillin e Emërimeve në Drejtësi, pse jo edhe me ndjekjen e Shkollës së Magjistraturës në procesin e testimit...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Më fal, të lutem!

Dhe e dyta, assesi nuk mundet që për këtë komision të adoptohet një formulë tjetër kompozimi jashtë asaj që ka përcaktuar ligji. Nuk dalim dot jashtë nenit 288, sepse zbatimi i ligjeve të reformës në drejtësi, kurdoherë, thotë Gjykata Kushtetuese, me vendimin 34 të vitit 2017, do të shihet me frymën e zhbllokimit të situatës.

Ja nuk erdhi opozita, siç nuk ka ardhur sot, çfarë do të bëjmë ne? Kështu që, të jemi të qartë: është komisioni që e kërkon ligji. A ka vend për përmirësim përmbajtja e projektvendimit? Sigurisht që ka vend. Edhe unë bashkohem me shqetësimet që ngriti kolegu Hyseni, ndonëse edhe unë vetë, si nismëtar, kam dy-tri gjëra në të cilat mund të ndërhyjmë, lidhur me afatet. Më duket i shkurtër afati dhjetëditor i aplikimit, po të kemi parasysh gamën e dokumentacionit që do të duhet të mbledhin kandidatët. Më duket i shkurtër afati 10-ditor. Po ashtu më duket i shkurtër edhe afati 3-ditor, i cili e detyron Komisionin e Ligjeve të mbledhet brenda 3 ditëve nga momenti i mbylljes së dorëzimit të aplikimeve nga kandidatët.

Për sa u përket kriterëve, unë jam shumë dakord të reflektohen ato që tha kolegu Hyseni, por ne si nismëtarë, kur u jemi referuar kriterëve, kemi marrë parasysh kriteret që përcakton Kushtetuta për anëtarët e Gjykatës Kushtetuese. Megjithatë, unë mendoj se qëndron vërejtja për ish-gjyqtarët dhe ish-prokurorët e larguar nga skema në 15 vjet, qoftë për shkak të vetingut, qoftë edhe me dorëheqje, nuk mund të rikthehen tani nga dritarja për të qenë pjesë e këtij komisioni, pavarësisht se ai ka 5 anëtarë, të cilët do të monitorojnë zbatimin e ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

Jemi të hapur për sa i përket përmbajtjes së këtij projektvendimi, por në raport me opozitën, ky nuk është konceptuar si një komision, ku ne do të reflektojmë raportet politike apo balancën pozitë-opozitë.

Natyrisht, do të ishte e mira të përfshiheshin dhe të ishin pjesë e diskutimit në këtë komision edhe kolegët opozitarë, pasi ata e kanë kërkuar vazhdimisht zbatimin e këtij neni, edhe në këtë komision.

Megjithatë, opozita e ka mundësinë të përfshihet deri në fazën e dërgimit të emrave të anëtarëve të këtij komisioni në Kuvend.

Edhe kolegu Fino e tha se ky është një komision që do të asistojë Kuvendin në nivel ekspertize të avancuar për të pasur një gjykim, lidhur me ecurinë e zbatimit të reformës në drejtësi dhe posaçërisht të ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” nga Kuvendi i

Shqipërisë. Kuvendi i Shqipërisë ka në finale përgjegjësinë për të parë ecurinë e zbatimit të reformës në drejtësi. Këtë ne kemi zgjedhur ta bëjmë nëpërmjet këtij organi.

Kolegu Fino tha se ky komision dublon Shërbimin e Monitorimit të Kuvendit. Në fakt ashtu duket në pamje të parë, por ky është një komision që ka shumë detyra në raport me ligjin “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”. Natyrisht, këto janë detyra të Kuvendit dhe të Komisionit të Ligjeve. Komisionin tonë nuk e përjashton askush nga procesi i monitorimit, i koordinimit dhe i zbatimit të reformës në drejtësi, sepse në fund të fundit, ky është organi më i lartë në Shqipëri.

Në këtë kuptim, e kisha të nevojshme t’i jap këto sqarime.

Urdhëroni, zoti Braho!

**Spartak Braho** – Jam plotësisht dakord, por nëse e patë me vëmendje, zoti Fino bëri një vërejtje shumë racionale. Fryma e projektvendimit është kryesisht monitorimi, bashkërendimi dhe koordinimi midis organeve, që merren me zbatimin e ligjit. Kjo do të thotë se ky komision nuk merr vendime dhe për këtë arsye, duhet patjetër të shtojmë fjalët: “të rekomandojë, të propozojë...”

Jeni dakord?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

E dyta, kam një pyetje: a do ta kalojnë vetingun këta?

Jo, sepse nuk është nevoja. Unë kështu mendoj.

**Ulsi Manja** – Jo, nuk është e nevojshme.

**Spartak Braho** – Për procedurë, do të thosha që të punojmë sot dhe ta kalojmë nesër për të pasur kohë për ta korrigjuar këtë projektvendim.

Unë jam më i vjetër se zonja Hysi dhe e kam drejtuar Komisionin e Ligjeve, kur zonja Hysi ishte në Helsinki.

Le të punojë më me kujdes, ta korrigjojë dhe të na sjellë një projekt tamam! Mos ta votojmë sot!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Kjo është nisma jonë.

Faleminderit, zoti Braho!

Vërejtjet dhe sqarimet tuaja qëndrojnë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Relatori, zoti Shameti, propozuesja dhe këshilltarët, të na thonë nëse mund të reflektohen në projektvendim të gjitha sugjerimet që bënë kolegët.

Urdhëroni, zonja Bushka!

Më pas e ka fjalën zoti Shameti!

**Klotilda Bushka** - Faleminderit, zoti kryetar!

Shumë shkurt.

Zoti Bashkim, shqetësimet që ngritët janë të gjitha shumë të vlefshme. Duke reflektuar mbi çështjen e vendimmarrjes, më lejoni t'ju sqaroj se vërtet nuk do të ketë vendime, të cilat do të duhet të merren për të ndryshuar një situatë, por ky komision do të marrë vendime për të miratuar një raport, të cilin do ta paraqesë këtu, sepse janë 5 veta. Do të duhet të marrë vendime për të kryer një veprim të caktuar dhe do t'u drejtohet organeve të vetingut. Ata janë 5 anëtarë, janë një organ kolegjal, kështu do të duhet t'u krijojmë mundësinë (në bazë të vendimit që ne kemi bërë), sepse më pas ky komision do të funksionojë në bazë të një rregulloreje që do ta miratojë vetë, por të paktën si fillim, do të na duhet t'u japim mundësinë, që ata të trajtohen si organ kolegjal. Ne kemi legjislacion për organet kolegiale në Shqipëri, për mënyrën se si ato i marrin vendimet, prandaj, mendoj se ajo që thoni qëndron në thelb, por proceduralisht, do të na duhet ta zgjidhim.

Për pjesën tjetër të ndryshimeve që u paraqitën këtu, unë jam shumë dakord me propozimin e zotit Hyseni për t'i dhënë një formë vendimmarrjes së komisionit, i cili pavarësisht se është në një farë mënyre këshillimor, raportues dhe informativ për efekt të zbatimit sa më të mirë të ligjit, pjesa që është në relacion për sa i takon paragrafit 8, që e referoi zoti Hyseni, mund të kthehet në një pikë të detyrat e komisionit (këtë e kam për këshilltarët e komisionit), sepse është e vlefshme për efektshmërinë e punës.

Te pjesa e afateve, propozoj që në vendim, te pika 10, afati 10-ditor për dorëzimin e aplikimit të kthehet në afat 15-ditor.

Te pika 11 afati 3-ditor të kthehet në afat 7-ditor. Kështu, mendoj se jemi brenda kohës normale të punës së të gjithë atyre që do të merren në Kuvend me shqyrtimin e kandidaturave dhe me përfundimin e procesit.

E fundit, për sa i takon shqetësimin, se a do të vazhdojë të jetë ky komision në momentin kur do të ngrihen organet e reja të drejtësisë, sepse pretendohet që ka mospërputhje midis relacionit dhe projektvendimit, mendoj se edhe ky shqetësim nuk qëndron, sepse po të lexohet me

kujdes, ndjekja dhe zbatimi i ligjit nga komisioni i pavarur e ka të kornizuar punën, sipas parashikimit të nenit 288 të ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Dakord, lapsuset që mund të jenë aty i rregullojmë, se është shumë e rëndësishme të kuptojmë logjikën në që do të vendosim. Logjika është: neni 288 e parashikon komisionin e pavarur për të bërë monitorimin dhe koordinimin e proceseve të zgjedhjes së anëtarëve të organeve të reja të qeverisjes të sistemit të drejtësisë dhe ndjekjen e zbatimit të ligjit vetëm për këtë çështje...

Në momentin që do të mbarojnë këto, ky komision do të ecë vetë pastaj, se edhe KED-ja që zgjidhet vit pas viti, derisa të kalojë kjo periudhë transitore, pastaj ligji parashikon mënyrën e vetorganizimit të të gjithë sistemit.

Kështu që, unë mendoj se nuk kemi pse e shtyjmë si fazë miratimi. Mendoj se këshilltarët do t’i reflektojnë të gjitha këto sa u thanë, dhe që janë të vlefshme, dhe në mund të kalojmë në procesin e votimit.

**Ulsi Manja** – E ndërmjetme.

**Klotilda Bushka** – Po, fazë e ndërmjetme.

Tek e fundit, do të jetë seanca plenare e së enjtes që do ta miratojë si vendim final.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Faleminderit!

Po, zoti Shameti.

**Adnor Shameti** – Për procedurë, zoti kryetar.

Në vijim të sqarimeve domethënëse të koleges Bushka dhe në vijim të sugjerimeve me vend të kolegut Hyseni, i ftoj anëtarët e komisionit që ta kalojmë draftin e paraqitur në komision, duke i siguruar të gjithë anëtarët e komisionit se të gjitha sugjerimet do të gjejnë pasqyrim në tekstin përfundimtar që do t’i paraqitet seancës.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Shameti!

Përpara se ta hedh në votim, kam një merak.

E para, duhet të gjejë reflektim, siç duhet, çështja e pengesës së subjekteve të rivlerësimit, që janë larguar për shkak të vetingut apo që kanë dhënë dorëheqjen pa iu nënshtruar vetingut. Edhe

pse mund t'i plotësojnë kriteret formale të 15-vjetëshit, si ish-gjyqtarë dhe ish-prokurorë, do të duhet të gjejë vend dhe reflektim në projektvendim.

E dyta, lidhur me afatin, ju thoni vërtet 15 ditë, por, në fakt, duke u nisur nga praktika e aplikimeve që janë bërë në Kuvendin e Shqipërisë, por për shkak edhe të dokumentacionit që kërkohet, që të mos detyrohemi ta shtyjmë përsëri afatin, do të ishte më mirë ta çonim 20 ditë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Sepse, ja nuk u dorëzuan brenda afatit 15-ditor, do të duhet ta shtyjmë përsëri afatin e aplikimit. Kështu që them më mirë ta lëmë 20 ditë.

*(Deputeti Shameti flet pa mikrofon.)*

15 ditë punë? Jam dakord, por edhe që afatin 7-ditor ta shkurtojmë në pesë ditë. Pra, mbledhjen e Komisionit të Ligjeve ta shkurtojmë nga shtatë, në pesë ditë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po, zoti Hyseni.

**Alket Hyseni** – Kam edhe një merak të vogël dhe, pastaj, besoj se do ta gjej më miratimin. Meqenëse ligji ia jep si kompetencë ndjekjen e ecurisë së zbatimit të parashikimeve të ligjit konkret, t'i japim mundësinë këtij komisioni që të citojmë këtu në ligj edhe detyrimin që organet të japin informacion, se mund të gjendemi në një situatë nesër, që nuk japin informacion dhe ky komisioni nuk mund të funksionojë mbi bazë informacionesh nga mediet, nga muhabetet. Ai do që t'i drejtohet me shkresë dhe të informohet zyrtarisht sa herë i drejtohet.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Të lutem, të gjej më një akord, që ta kemi edhe një parashikim të tillë që organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë kanë për detyrë t'i përgjigjen çdo kërkesë për informacion sa herë që komisioni u drejtohet.

**Ulsi Manja** – Jam shumë dakord.

**Alket Hyseni** – Formulimin e rregullojmë.

**Ulsi Manja** – Sugjerimet e të gjithë kolegëve qëndrojnë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po, zoti Fino.

**Bashkim Fino** – Jo, meqenëse e votojmë nen për nen dhe në tërësi, siç duket, me pikat do të merreni ju me relatorin apo me komisionin, unë këmbëngul përsëri, pavarësisht mendimeve shkatërruese që dha zonja Bushka, kundër një pike (pikës 6), ku thuhet: “Vendimet e komisionit”...



Dëgjoni me kujdes: “...quhen të miratuara me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve”.  
Ja, një anëtar nuk voton...

**Ulsi Manja** – E zgjidhim.

**Bashkim Fino** – Prisni, ta mbaroj si ide...

**Ulsi Manja** – Po.

**Bashkim Fino** – ...se duhet zbutur pak!

Ja një anëtar nga ata të pestë thotë: “Jo, nuk e votoj”. Domethënë, edhe pse ata të katër e votojnë, dhe që quhet me shumicë dërrmuese, nuk të vjen dot relacioni këtu, sepse nuk e votoi njëri anëtar. Pra, kjo duhet rregulluar.

*(Deputetja Bushka ndërhyrje pa mikrofon.)*

Jo, moj zemër, por e ke të shënuar kështu: “Vendimet e komisionit quhen të miratuara me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve”.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Në rregull, shumicë, por...

**Ulsi Manja** – Mund të zgjidhet duke iu referuar ligjit “Për organet kolegjiale”.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Më falni, ju lutem!

**Bashkim Fino** – Pse me votat e të gjithë anëtarëve?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

E di si e thua ti? Ti e bën të cilësuar.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Zoti Fino, jam shumë dakord.

Kemi ligjin “Për organet kolegjiale”, pesë do të ketë komisioni, me tre anëtarë merret vendimi.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zoti Hyseni, është çështje të cilën do të duhet ta reflektojmë.

Tani, unë bie dakord me të gjitha sugjerimet dhe vërejtjet që kolegët i bënë këtij projektvendimi dhe e them shumë sinqerisht: e rëndësishme ishte nisma, por plotësimi që i bëhet këtij projektvendimi, me sugjerimet dhe komentet tuaja, është shumë i vlefshëm. Shpresoj dhe besoj të jenë mbajtur shënime të gjitha. Pastaj, pse jo, relatori së bashku me propozuesen, përpara se të zbardhet projektvendimi, të shohin nëse janë zbardhur të gjitha sa u thanë këtu.

Le ta hedhim në votim projektvendimin “Për ngritjen e Komisionit të Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e zbatimit të ligjit nr. 115 të vitit 2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

Kush është pro me propozimet dhe sugjerimet e bëra nga kolegët deputetë? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Atëherë, miratohet projektvendimi “Për Ngritjen e Komisionit të Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e Zbatimit të ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, me vërejtjet dhe sugjerimet e bëra nga kolegët.

E mbyllim këtu, me këtë vendimmarrje, mbledhjen e sotme të Komisionit të Ligjeve. Mbledhja e radhës, së bashku me rendin e ditës, do t’ju njoftohen nga sekretaria e komisionit.

Edhe një herë, shfrytëzoj rastin t’i bëj thirrje opozitës që të bashkohet dhe të bëhet pjesë aktive në ngritjen e këtij komisioni, pasi është një detyrim që buron nga ligji, por edhe i kërkuar, pse jo, në të gjitha diskutimet e bëra në këtë komision nga opozita.

Faleminderit dhe ditë të mbarë!

## **MBYLLET MBLEDHJA**

